



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



Raporti vjetor i punës së Zyrës për Komunikim me Publikun Janar – dhjetor 2025

Detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrës për Komunikim me Publikun (ZKP)

- Merr pjesë në takimet e drejtpërdrejta të Kryetarit të Komunës brenda dhe jashtë Komunës;
- Përcjellë mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa, Komitetit për Komunitete dhe mbledhjet e Kuvendit të Komunës;
- Koordinon punët me mediat lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me aktivitetet e Kryetarit të Komunës, drejtorëve të drejtorive dhe zyrave të tjera të Komunës;
- Koordinon punët për zhvillimin dhe zbatimin e akteve komunale për komunikim me publikun;
- Ofron informacione për projektet komunale;
- Siguron transparencë dhe qasje publike për punën e drejtorëve të administratës komunale, të institucioneve arsimore dhe shëndetësore dhe të ndërmarrjeve publike lokale, duke iu ofruar informata dhe dokumente qytetarëve dhe mediave;
- Informon publikun për vendimet, rregulloret dhe dokumentet tjera që i miraton

Kuvendi, përmes njoftimeve në uebfaqen zyrtare të Komunës, në rrjete sociale;

- Kontakton me mediat lokale dhe ato qendore për çështjet në interes të Komunës dhe të qytetarëve;
- Siguron informacione brenda Komunës dhe është në bashkëpunim të përhershëm me drejtorët e drejtorive dhe shërbyesit civilë të punësuar në drejtoritë e administratës;
- Shoqëron përfaqësuesit e mediave brenda Komunës dhe regjistron deklaratat e zyrtarëve komunalë dhënë për media të ndryshme lokale dhe ato qendore;
- Kryen edhe punë të tjera të parapara me ligj dhe me rregulloret tjera.

Zyra për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim (ZKP), përtej detyrave dhe përgjegjësi të lartëcektna, në baza të rregullta merret edhe me forma të tjera të komunikimit, siç është ajo përmes rrjeteve sociale.

Pra, për këtë qëllim, stafi i ZKP menaxhon edhe faqen e Komunës së Podujevës në Facebook, uebfaqen e Komunës, u kthen përgjigje të gjitha pyetjeve që vijnë nga mediat, organizatat e shoqërisë civile dhe qytetarët.

Po ashtu, kjo Zyrë në bashkëpunim me zyrtarin për qasje në dokumente publike, koordinon punën për të kthyer përgjigje në secilën kërkesë që i adresohet Komunës së Podujevës, përmes kërkesës për qasje në dokumentet publike.

Në bashkëpunim me zyrtarët përgjegjës në kuadër të Kabinetit të Kryetarit të Komunës, ZKP merr pjesë edhe në organizimin e vizitave në terren, ceremonive të ndryshme të përirimit të projekteve të Komunës për të cilat përgatit komunikata dhe të njëjtat i publikon në uebfaqe dhe rrjete sociale dhe ua përcjell edhe mediave.

Po ashtu, varësisht nga rëndësia e projekteve, disa prej tyre paraqiten edhe me video të cilat realizohen nga stafi i Zyrës dhe nga kontrata e lidhur me një operator, e cila po ashtu menaxhohet nga ZKP.

ZKP, bazuar në rregullativën ligjore, përcjell debatet publike të Kornizës Afatmesme Buxhetore, dëgjimet buxhetore dhe raportimet vjetore të Kryetarit me qytetarë, të cilat parashihen të mbahen gjatë një viti kalendarik, përgatit procesverbalet dhe komunikatat dhe së bashku me fotot e debateve i publikon në uebfaqen zyrtare dhe në rrjete sociale të Komunës.

Për çështje me rëndësi për Komunën dhe qytetarët ZKP në bashkëpunim me Kabinetin e Kryetarit organizon edhe konferenca për media, në të cilat ftohen mediat lokale dhe nacionale

dhe për të njëjtat publikohen komunikatat në uebfaqen e Komunës dhe platformat tjera në rrjetet sociale.

Në vitin 2025 Komuna e Podujevës ka kontraktuar një kompani për transmetimin e mbledhjeve të Kuvendit, transmetimin e ngjarjeve kulturore dhe ngjarjeve tjera me rëndësi, kontratë kjo e cila menaxhohet nga Zyra për Komunikim me Publikun.

Në esencë, qëllimi i lidhjes së kësaj kontrate është që Kuvendi, pra vendi ku përfaqësohen të gjithë qytetarët përmes partive politike, të bëhet videotransmetimi i seancave në mënyrë që të kenë mundësi t'i përcjellin mbledhjet të gjithë qytetarët, duke rritur kështu komunikimin me qytetarë dhe transparencën e Komunës.

Po ashtu, si Zyrë përcje secilin takim të Komitetit për Politikë dhe Finance (KPF), mbledhjet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), mbledhjet e Komitetit për Komunitete (KK), Shtabin Lokal Emergjent dhe shtabet e tjera që funksionojnë përgjatë vitit, të cilat gjithmonë pasohen me komunikata zyrtare në uebfaqen e Komunës dhe rrjete sociale.

Zyra për Komunikim me Publikun përveçqë zbaton detyrat brenda përgjegjësisë dhe fushëveprimit që ka, angazhohet edhe në secilin aspekt tjetër të komunikimit me qëllimin e vetëm që qytetarët, mediat dhe institucionet që monitorojnë punën e Kuvendit dhe Komunës të jenë të informuar me kohë për të gjitha zhvillimet që ndodhin brenda këtyre institucioneve.

Për këtë qëllim është publikuar numri kontaktues i Zyrës dhe e-mail adresa infopodujeva@rks-gov.net, ku organizata të ndryshme, media dhe qytetarë na kontaktojnë dhe dërgojnë email-e në të cilat përgjigjemi sa më shpejt që është e mundur.

Trajtim të veçantë gjithmonë u kushtohet njoftimeve publike, të cilat përveçqë publikohen në uebfaqen zyrtare, ato i vendosim edhe në tabela në qytet dhe në bashkësitë lokale, Orllan, Lluzhan dhe Kërprimë dhe lokalitete të tjera me qëllim që njoftimet të arrijnë te secili qytetar.

Për secilin aktivitet të Kryetarit të Komunës, Kuvendit, Ekzekutivit, etj., përmes uebfaqes zyrtare, platformës Facebook dhe me e-mail, njoftohen mediat e shkruara, elektronike dhe qytetarët.

Me qëllim të rritjes së transparencës komunale, llogaridhënies dhe gjithpërfshirjes në proceset vendimmarrëse, gjatë vitit 2025 janë miratuar në Kuvendin Komunal Draft-Rregullorja për Transparencë e Komunës së Podujevës dhe Draft-Plani për Transparencë Komunale 2025-2029. Procesin e hartimit të këtyre dy dokumenteve e ka udhëhequr Zyra për Komunikim me Publikun në kuadër të Grupit punues të formuar me vendim të Kryetarit.

Në forme tabelare janë paraqitur lajmet, njoftimet, shpërndarjet, reagimet/sqarimet, videot, ftesat-thirrjet dhe mbledhjet e Kuvendit Komunal dhe Ekzekutivit të postuara ne uebfaqen zyrtare të Komunes dhe në rrjetin social Facebook.

Muaj	Lajme	Njoftime	Shpërndarje	Reagime/ Sqarime	Video	Ftesë/ Thirrje Publike	Mbledhje të Kuvendit
Janar	18	6	5	0	3	3	1
Shkurt	14	4	2	0	3	1	1
Mars	20	11	10	1	2	4	2
Prill	20	12	10	1	4	4	1
Maj	19	14	4	1	3	1	1
Qershor	33	22	6	0	9	5	2
Korrik	22	20	5	2	5	2	1
Gusht	21	13	7	0	9	1	0
Shtator	25	15	6	0	6	2	1
Tetor	14	3	0	0	1	5	1
Nëntor	18	14	1	0	6	2	1
Dhjetor	30	16	4	0	10	4	1
Totali	254	150	60	5	61	34	13

Njoftime	Konkurse	Aplikacione/ Formular	Subvencione	Thirrjet e mbledhjeve	Ftesa
209	42	8	32	26	13

Vendimet e Kryetarit	Numri i vendimeve të publikuara në uebfaqe zyrtare
Muaji Janar	15 vendime
Muaji Shkurt	24 vendime
Muaji Mars	20 vendime
Muaji Prill	22 vendime
Muaji Maj	12 vendime
Muaji Qershor	10 vendime
Muaji Korrik	31 vendime
Muaji Gusht	11 vendime
Muaji Shtator	13 vendime
Muaji Tetor	14 vendime
Muaji Nentor	17 vendime
Muaji Dhjetor	44 vendime
Totali i vendimeve te publikuara ne 2025	233 vendime

Vegëza: <https://podujeve.rks-gov.net/vendimet-kryetarit/>

Njoftim për dhënie të kontratës	Njoftime për nënshkrim të kontratës	Njoftime për kontratë	Kontrata të prokurimit	Vendime të OSHP –së	Njoftim për anulim të aktivitetit të prokurimit	Njoftime të ndryshme të prokurimit
69	97	4	77	1	18	356

Vegëza: <https://podujeve.rks-gov.net/prokurimi/>

Në kuadër të njoftimeve janë publikuar shpenzimet nga Drejtoria e Financave për 12 muaj të vitit 2025, raportet periodike financiare, Korniza Afatmesme Buxhetore 2026-2029, draft-buxheti dhe dokumente tjera nga fusha e financave.

<https://podujeve.rks-gov.net/pasqyrat-financiare/>

<https://podujeve.rks-gov.net/shpenzimet/>

<https://podujeve.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/11/1.Vendim-miratimi-i-buxhetit-per-2026-dhe-planifikimet-per-2027-2028-1-1.pdf>

<https://podujeve.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/01/KAB-2026-2028-FINALE-3.pdf>

Nga zyra e Kryesuesit të Kuvendit janë publikuar të gjitha materialet e Kuvendit për mbledhjet që janë mbajtur në vitin 2025, të gjitha procesverbalet e mbledhjeve, procesverbalet e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe procesverbalet e Komitetit për Komunitete. Gjithashtu është bërë edhe publikimi dhe transmetimi i të gjitha mbledhjeve;

Vegëzat:

<https://podujeve.rks-gov.net/procesverbalet/?tax=ekstraktet-e-procesverbaleve-te-kuvendit>

<https://podujeve.rks-gov.net/procesverbalet/?tax=ekstraktet-e-procesverbaleve-te-komitetit-per-politike-dhe-financa>

<https://podujeve.rks-gov.net/procesverbalet/?tax=ekstraktet-e-procesverbaleve-te-komitetit-per-komunitete>

<https://podujeve.rks-gov.net/video-incizimet-e-mbledhjeve/>

Ndërsa, për të parë formën e plotë të postimit të lajmeve në uebfaqen zyrtare, të cilat për vitin 2025 kanë qenë në numër **254 postime**, klikoni vegezën;

[Lajmet - Komuna Podujeve](#)

Në kuadër të Zyrës për Komunikim me Publikun janë bërë edhe të gjitha njoftimet e dokumenteve të inicuar nga drejtoritë e ndryshme për konsultim publik, njoftime për debatin publik, përgatitja e raportit të mbajtjes së konsultimeve publike për vitin 2025, si dhe Plani i konsultimeve publike për vitin 2026.

Këto plane dhe raporte janë të publikuara në uebfaqen zyrtare të Komunës së Podujevës dhe në platformën qendrore E-konsultimet. Për më shumë klikoni vegezat;

[Aktet Për Diskutim Publik - Komuna Podujeve](#)

[Konsultat publike | Konsultimet publike](#)